

Kronikë

Sherri për drutë, 50-vjeçari vritet nga bashkëfshatari me breshëri kallashnikovi në Fushë-Krujë! Policia ngre dronin në kërkim të autorit (EMRAT)

Një 50-vjeçar është qëlluar për vdekje me breshëri kallashnikovi nga bashkëfshatari i tij. Mësohet se shkak i sherrit mes tyre është bërë një debat për prerjen e druve në pyll. 50-vjeçari mori plagë në bark, të cilave nuk mundi t'u mbijetonte.

■ Del FOTO ja kush është autori

■ EMRAT/ Ja kush janë viktima dhe autori

[Sh.com]

Redaksia

10 Gusht, 10:30 | Përditësimi i fundit: 10 Gusht, 15:31

A A

FUSHË-KRUJË- Një 50-vjeçar është qëlluar për vdekje me breshëri kallashnikovi nga bashkëfshatari i tij. Mësohet se shkak i sherrit mes tyre është bërë një debat për prerjen e druve në pyll, që ka çuar deri në përdorimin e armës nga njëri prej tyre. Viktimë ka mbetur Luan Hushi, i cili paai u plagos u dërgua në spitalin e Traumës në Tiranë. Hushi nuk mundi t'i mbijetojë plagëve të rënda që kishte marrë në bark.

Policia ka identifikuar dhe shpallur në kërkim autorin e dyshuar, Klodian Keqi, 35 vjeç. Pas debatit që kanë pasur, dyshohet se Keqi ka qëlluar me kallashnikov Hushin dhe më pas është larguar. Report Tv mëson se policia ka ngritur dronin për të bërë të mundur lokalizimin e autorit të dyshuar.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Rama: Gati të nënshkruajmë protokollin e bashkëpunimit me El Alabbar, i hap rrugë fillimit të investimit në Portin Turistik të Durrësit

Autori Klodian Keqi, rezultoi një person me precedent të mëparshëm penal. Në vitin 2010, Keqi, sëbashku me vëllanë e tij kanë tentuar të vrasin një person, Mustafa Dacin. Shkak është bërë një konflikt i vjetër që kanë pasur familja Keqi dhe Daci më parë për çështje pronësie. Mes tyre kishte pasur edhe më parë përplasje, por në 2010 dy familjet patën shkëmbim me armë zjarri në mes të rrugës. Nga shkëmbimi me armë zjarri në atë kohë, mbetën të plagosur Mustafa Daci dhe vëllai i Klodianit, Jetmir Keqi.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 11:33


Qëlloi për vdekje me breshëri kallashnikovi bashkëfshatarin, del FOTO ja kush është autori



Klodian Keqi dyshohet se është autori i vrasjes së Luan Hushit në Fushë-Krujë. Keqi ka qëlluar me breshëri kallashnikovi bashkëfshatarin e tij, pas sherrit që kanë pasur për prerjen e druve në pyll. Report Tv ka siguruar foton e Klodian Keqit.

Ora 11:13

U plagos me armë zjarri nga bashkëfshatari në Fushë-Krujë, ndërron jetë 50-vjeçari



50-vjeçari Luan Hushi, i cili u plagos nga bashkëfshatari i tij në Fushë-Krujë ka ndërruar jetë. Hushi u dërgua në spitalin e Traumës, por nuk i mbijetoi dot plagëve të marra.

Ora 10:59

Plagosja me armë zjarri në Fushë-Krujë, mësohet shkak i sherrit mes dy fqinjëve



Një sherr për drutë në pyll, dyshohet se është shkak i sherrit mes dy fqinjëve, i cili çoi deri në përdorimin e armës së zjarrit. Klodian Keqi ka plagosur me armë zjarri Luan Hushin.

Ora 10:39

Të shtënat me armë zjarri në Fushë-Krujë, ja kush janë i plagosuri dhe autori (EMRAT)



Nga të shtënat me armë zjarri ka mbetur i plagosur Luan Hushi, ndërsa autor është Klodian Keqi. Mësohet se të dy janë bashkëfshatë.

SH.com

Si.E./B.K./Shqiptarja.com

TAG: [fushë-krujë](#) [Durrës](#) [Luan Hushi](#) [Klodian Keqi](#) [plagosja me armë zjarri](#)

Komento

Komente

Anëbërori: 10/08/2022 15:17

Puashëri kriminel me Edvin shijuan shqijfollet e kan programuar zhbërjen e Shqipërisë, o emnigim o vrasje duke then " te t'i han kokat njeri tjetri " ju kujtohet o të verbuar. Fjalën e kam për delet e këti tradhtari!

Përgjigju

Labir: 10/08/2022 18:21

Andej nga Fushë Kruja pine birra bashke e ne fund njerzrin airmn kush paguan pastaj fanno e ka qeveria.

Përgjigju

Bledi: 10/08/2022 14:53

Nje bravo ???? e madhe per policine, qe arriti ti sekuestroje gezhojat ne kote rekord

Përgjigju

Drejtësi: 10/08/2022 12:12

Ekzekutojten ne skalon kermen se burgu nuk ju ben pershtypje. Nese nuk veprohet keшту si ne vitet '98 - 2001 nga Policia atehere rrezikojme shume si popull dhe vrasjet per motive skandaloze nuk do ndalen.

Përgjigju

Lushka: 10/08/2022 11:26

Qeveri te poshtira i lat njerezit analfabeta edhe primitiv i Injorance ne kulum te vritesh per Dru! Kauz e humbur qe ne mendimet! Hapni mer shkolla arsimin dituri te ndajme te drejten Civile nga penalla te din nese Ben veper penale hyn ne burg! Mjerim analfabetizem doktrine fetare ne maksimum! Ne vend te hapni kisha e xhamija hapni dituri hapni arsimimi! Lart drogues larg vrasjeve larg cdo gjaje te keqet Doni edhe me hyn ne Europet! U merrte qe su bie te gjithë politikaneve edhe e quani arritje!

Përgjigju

Jon: 10/08/2022 11:23

Pse ka kaq shum gomere ne kete zone...

Përgjigju

Turi: 10/08/2022 11:23

Egersira qe na duket vetja se jemi trima por ne te vertete jemi kombi me i ndyre qe ka universi, duhet te na dergojne ne shpejllat e Amazones dhe mos te na lejojne te dalim se bejme shume te keqija . Meri drute tani qe vdiq ai dhe te shikosh ne p te robeve o egersire

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A po menaxhohet si duhet situata me zjarret në vend?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë



Zjarri i përmasave të mëdha në Lenie të Gramshit
10 Gusht, 20:25

Ekonomi



Ndërtimi i portit turistik të Durrësit, investitori Muhammed El Alabba: Premtoj se do të marrim mendjet më të mira për krijimin e një jete të re
10 Gusht, 20:24

Ekonomi



Balluku jep detaje nga baza e NATO-s në Porto Romano, që u prezantua Bruksel
10 Gusht, 20:20

Ekonomi




Rama krah El Alabbar: Mbyllëm negociatat! Do nënshkruajmë protokollin e bashkëpunimit, i hap rrugë fillimit të investimit në Portin Turistik të Durrësit
10 Gusht, 20:14

Opinion




Skender Minxhozi: Kur Meta e Berisha refuzojnë të shihen në pasqyrë
10 Gusht, 20:07

Politikë



Meta-Ramës: Unë jam Ilir Rexhep Metaj, se kam ndryshuar asnjëherë
10 Gusht, 19:56

VIP & Spektakel



Sunny Hill Festival, Dukagjin Lipa jep njoftimin e rëndësishëm: Bileta juaj e Përfundimit, e vlefshme në Tiranë
10 Gusht, 19:54

Kronikë



Aksidenti në Pogradec, makina përplasat me motorin, plagoset 45-vjeçari dhe djali i tij i mitur
10 Gusht, 19:44

Sociale




Inxhinieria 'mund' mjekësinë! Maturantët zgjedhin arsimin profesional! Britten aplikuesit në degët bujqësore dhe mësuesi
10 Gusht, 19:44

Sociale




Ministria Kushin ndan lajmin e mirë! Shtohen edhe 150 shkolla në projektin 'Bëjme Detyrat e Shtëpisë'
10 Gusht, 19:40

Politikë



Meta: Unë i bie më të fortit, e kësaj në mes e s'e bëj me porosi! Rama, o bastard
10 Gusht, 19:37

Politikë



Premtimi i Metës: Shtatori do të jetë përvëlues! Siç shemba kioskat e të fortëve të Tiranës, do të shemb edhe këtë regjim që vjedh
10 Gusht, 19:31

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje